



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 212/4 prot.

Tiranë, më 02.04.2026

**V E N D I M**

Nr. 28, datë 02.04.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, SË  
PROCEDURËS SË KONKURRIMIT TË ZHVILLUAR PËR PLOTËSIMIN E  
POZICIONIT TË PUNËS, NË NIVEL EKZEKUTIV, TË SHPALLUR  
ME KOD #253, NGA BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit me kod #253, të shpallur nga Bashkia Tiranë,

**VËREJ SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën nr. 212 prot., datë 02.02.2026, të dërguar nga konkurrentja Gentjana Palushi, pjesëmarrëse në procedurën e konkurrimit me kod #253, për plotësimin e pozicionit “Specialist”, në Sektorin e Investimeve në Objektet Publike e Civile, Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike, klasa e pagës III-b, të shpallur nga Bashkia Tiranë, në përmbajtje të së cilit ngrihen pretendime për vlerësim të padrejtë gjatë procesit të konkurrimit, nga ana e Komisionit të Brendshëm për Lëvizjen Paralele (KBLP).

Në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, rezulton se konkurrentja Gentjana Palushi, ka shprehur interesin për të marrë pjesë në

procedurën e konkurrimit, faza e lëvizjes paralele, e shpallur me kod #253, nga Bashkia Tiranë, për plotësimin e pozicionit të evidentuar më sipër.

Referuar procedurës së konkurrimit të zhvilluar, kandidatja parashtron se janë lejuar parregullsi në veprimet e kryera nga Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele (KBLP), gjatë procesit të vlerësimit dhe rivlerësimit të intervistës së strukturuar me gojë.

Në këto kushte, duke mos qenë dakord me rezultatin e vlerësimit, kandidatja i është drejtuar Komisionerit, duke kërkuar verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara nga ligji, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, në fazën e lëvizjes paralele.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga konkurrentja Gentjana Palushi, në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka filluar procesin e verifikimit të informacionit dhe nëpërmjet shkresës nr. 212/1 prot., datë 17.02.2026, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e infomacionit të ardhur me shkresën nr. 212 prot., datë 02.02.2026, pranë Komisionerit, të dërguar nga kandidatja Gentjana Palushi”, ka njoftuar institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure konkurrimi, duke i kërkuar edhe dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 7064/1 prot., datë 25.02.2026, “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 212/2 prot., datë 02.03.2026, ka dërguar dokumentacionin e kërkuar, nga analiza e të cilit rezulton se:

Në mbështetje të dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, në të cilin normohet instituti i rekrutimit, njësia përgjegjëse pranë institucionit të Bashkisë Tiranë ka dërguar për publikim pranë AKPA-së, shpalljen me kodin # 253, për plotësimin e pozicionit vakant objekt shqyrtimi, nëpërmjet shkresës nr. 40130 prot., datë 21.11.2025, të cilin e ka publikuar edhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit.

Në vijim të analizës së bazës ligjore që rregullon këtë proces, rezulton se:

- Në pikën 6, të kreut VII, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, përcaktohet se, konkurrimi për procedurën e lëvizjes paralele zhvillohet në dy faza:
  - 1) verifikimin e kandidatëve, të cilët përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
  - 2) vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.

- Ndërsa, bazuar në pikën 7, të kreut VII, të aktit nënligjor të sipërcituar, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Në plotësim të këtij detyrimi ligjor, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë, ka kryer verifikimin paraprak të kandidatëve dhe me aktin nr. 41822 prot., datë 09.12.2025, “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive*”, për fazën e lëvizjes paralele, është kualifikuar kandidatja Gentjana Palushi. Rezulton se, nuk ka pasur kandidatë të s’kualifikuar në këtë fazë të konkurrimit.

Më tej, me urdhërin nr. 2155 prot., datë 19.12.2025, “*Për ngritjen e Komitetit të Pranimit Për Lëvizjen Paralele*”, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (*titulli i aktit nuk është në përputhje me ligjin*), është ngritur Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele, në përbërje të të cilit janë caktuar **3** anëtarë:

- E. Miço, në cilësinë e përfaqësuesit nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit;
- V. Dishnica, në cilësinë e eprorit direkt;
- E. Toska, si anëtar i zgjedhur nga titullari i institucionit.

Konstatohet se, përbërja e Komisionit është në përputhje me përcaktimet e pikës 12, të kreut VII, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar.

Në vijim, KBLP-ja, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në pikën 16, kreu VII, i VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, ka hartuar pyetjet e intervistës së strukturuar me gojë (*6 pyetje*) dhe anëtarët e Komisionit kanë nënshkruar deklaratën e paanësisë.

Më pas, në datën 22.12.2025, ora 12:00, kandidatja e kualifikuar është paraqitur për zhvillimin e intervistës së strukturuar me gojë, dokumentuar në procesverbalin e datës 22.12.2025, “*Procesverbal i konstatimeve të situatave të veçanta*”, të hartuar nga KBLP-ja. Rezulton se, është nënshkruar deklarata për pranimin ose jo të regjistrimit me zë të intervistës me gojë, ku kandidatja G. Palushi ka zgjedhur *të mos regjistrohet*. Në këto kushte, pretendimet me objekt këtë fazë të konkurrimit, konkretisht përfshirjen në procesverbal të një pyetjeje shtesë, nuk mund të ngrihen, pasi është objektivisht i pamundur verifikimi i tyre.

Pas përfundimit të intervistës së strukturuar me gojë, në përputhje me pikat 17 dhe 18, të kreut VII, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, e ndryshuar, anëtarët e KBLP-së kanë kryer vlerësimin e kandidates. Ky vlerësim është pasqyruar në aktet e datës 22.12.2025, të hartuara nga Komisioni, nga rezulton se kandidatja G. Palushi është vlerësuar gjithsej me 67 pikë, duke mos u kualifikuar si fituese.

Më tej, pas njoftimit të kandidatës G. Palushi për rezultatin e vlerësimit, nga njësia përgjegjëse, kandidatja duke mos qenë dakord me rezultatin përfundimtar, është ankuar pranë KBLP-së, duke kërkuar rivlerësimin e intervistës së strukturuar me gojë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se, KBLP-ja është mbledhur për rishikimin e vlerësimit dhe, në përfundim të procesit të rivlerësimit të intervistës së strukturuar me gojë, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke e vlerësuar kandidaten G. Palushi, me 67 pikë. Ky vendim i KBLP-së i është njoftuar kandidatës përmes e-mailit të datës 30.12.2025.

Në vijim të analizës së rrethanave të këtij rasti në raport me pretendimet e parashtruara në informacion, rezulton se:

- Në lidhje me pretendimin për mungesë koherence në vlerësimin e intervistës së strukturuar me gojë dhe vlerësimit të CV-së, konstatohet se, organi i ngarkuar nga ligji për kryerjen e kësaj procedure vlerësimi, në rastin konkret KBLP-ja, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për vlerësimin e kandidatës në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.
- Sa i përket pretendimit të parashtruar nga kandidatja në informacionin e rastit konkret, në lidhje me mospërputhjen e klasës së pagës së pozicionit, të pasqyruar në procesverbalin e KBLP-së dhe në shpallje, institucioni ka sqaruar se kjo situatë lidhet me një mospasqyrim teknik në sistemin elektronik të rekrutimit, i cili nuk kishte reflektuar përditësimet e fundit të klasifikimit të kategorive të pagave. Sipas sqarimit të dhënë, klasa e pagës III-b është ekuivalente me kategorinë IV-1 sipas strukturës së re të miratuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023, *“Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”*, i ndryshuar, dhe kjo mospërputhje nuk ka ndikuar në kriteret e konkurrimit, apo në trajtimin financiar të pozicionit.

Referuar sa më lart, vlerësohet se, gjatë zhvillimit të kësaj procedure konkurrimit nuk është evidentuar cënim i parimeve të transparencës, objektivitetit dhe barazisë në konkurrim, si dhe nuk konstatohen elementë që mund të sjellin paligjshmërinë e procedurës së konkurrimit të zhvilluar nga Bashkia Tiranë.

Në përfundim të analizës së fakteve të parashtruara më sipër, arrihet në konkluzionin se, procedura e konkurrimit e zhvilluar për plotësimin e pozicionit vakant të punës *“Specialist”*, në Sektorin e Investimeve në Objektet Publike e Civile, Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike, Bashkia Tiranë, është zhvilluar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Vendimin

nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.

### **Për këtë arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit nr. 212 prot., datë 02.02.2026, të paraqitur nga kandidatja Gentjana Palushi, pasi nuk janë konstatuar parregullsi në veprimet administrative të kryera nga subjektet e ngarkuara prej ligjit, gjatë realizimit të procedurës së konkurrimit.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Bashkisë Tiranë, si dhe kandidatja Gentjana Palushi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Lefterije Lleshi (Luzi)**